



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

**DREJTORATI PËR BUJQËSI , PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL**

**Reference: 12-320**

<b>Datë:</b>	<b>05.07.2016</b>
<b>Për:</b>	<b>z.Imri AHMETI - Kryetar i Komunës së Lipjanit</b>
<b>Nga:</b>	<b>Feti KRASNIQI -Drejtore i Drejtoratit për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural</b>
<b>Lënda:</b>	<b>Raporti i punës për muajin Korrik : 2016</b>

**Shtojcë:** Plani i aktiviteteve të Drejtoratit për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural për Muajin Korrik të vitit **2016**

- **DBPZHR ne Lipjan per muajin Korrik : 2016 , ka zhvilluar këto aktivitete**

### **Aktivite profesionale :**

- Takimet javore në Bordin e Drejtorëve
- Takimet me stafin lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë në punë
- Ka vazhduar Përforcimi i shërbimeve këshillimore të organizuara nga MBPZHR.
- Kemi mbajtur takime me grupe te fermereve,
- Kemi formuar komisionin për përcjelljen e Korrje –shirjeve 2016
- Drejtorati i Bujqësisë në Lipjan , duke vlerësuar të domosdoshëm vlerësimin e situatës , kemi angazhuar komisionin profesional për vlerësimin e dëmeve.
- Kemi përgatitur raportin e korrjeve 2016

### **RAPORT**

#### **I KORRJE-SHIRJEVE PËR VITIN 2016 NË KOMUNËN E LIPJANIT**

**Fillimisht po japim një pasqyrë tabelare për sipërfaqet e mbjellura me drithëra të bardha në Komunën e Lipjanit .**

Kultura bimore	Mbjelljet vjeshtore	Mbjelljet pranverore
Grurë	5320 (ha)	/
Elb vjeshtorë	30(ha)	/
Elb i birrës	/	88(ha)
Thekër	15 (ha)	/
Tërshërë	/	130(ha)
<b>Gjithësej</b>	<b>5365 (ha)</b>	<b>218 (ha)</b>
	<b>5583 (ha)</b>	

Fushata e korrje -shirjeve sivjet në arat e Komunës së Lipjanit ka filluar me **03.07.2016** fillimisht me elb të birrës dhe ka vazhduar me grurë.

Këtë vitë në Komunën e Lipjanit për këtë fushatë janë të angazhuara mbi 130 autokombajna, prej të cilave një numër i madh i tyre janë në gjendje të mirë, por megjithatë është e nevojshme që të ketë një kontrollë të gjendjes teknike të autokombajnave.

Është planifikuar që nëse zotrojnë kushtet e përshtatshme të motit me diell për 15 ditë të përfundojnë korrje – shirjet .

Mirëpo prej datës 16.07. deri më 20.07.2016 janë ndërprerë korrje- shirjet për shkak të motit dhe lagështisë.

Me drithëra të bardha këtë vit në komunën e Lipjanit janë të mbjellur mbi 5583 ha .

Gjendja e grurit në përgjithësi është e kënaqëshme, falë kushteve të mira klimatike.

Ecuria e fushatës së korrje – shirjes ka vijuar pa pengesa të mëdha.

Naftë si dhe pjesë ndërrimi ka pasur mjaft, vetëm se çmimet kanë qenë mjaft të larta dhe jo të arsyeshme për kombajner.

Si çdo vitë edhe sivjet Drejtorati i Bujqësisë ka formuar komisionin i cili ka përcjell fushatën e korrje – shirjeve.

Në bazë të përmbledhjes së shënimeve nga terreni Komisioni i formuar nga Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari në Lipjan konstaton me sa vijon:

- Çmimi i kombajnimit i rekomanduar nga Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me Drejtoratet për Bujqësi, ka qenë (100 €/ha).
- Rendimentet kanë qenë të ndryshme dhe kanë ndryshuar parcelë prej parcele dhe atë me një rendiment mesatarë **4500kg/ha**. Ka pasur parcela me rendiment edhe mbi 7000 kg/ha. Ndërsa rendimenti mesatarë i elbit ka qenë 3500kg / ha, kurse i tërshërës 2700 kg/ ha .
- Depot për grumbullimin e drithërave kanë qenë të përgaditura mirë ku paraprakisht është bërë D.D.D.(Dezinfektimi,Dezinsektimi, Deratizimi) dhe kapaciteti i tyre ka qenë i mjaftueshëm për grumbullimin e gjithë sasisë së drithërave në territorin e Komunës së Lipjanit pasi që Komuna e Lipjanit posedon 10 mullinj elektrik në funksion me kapacitet të lartë përpunues.
- Disa mullisë nuk e kanë pranuar tërë sasinë e grurit nga fermerët për arsye të tyre që nuk i dimë.
- Çmimi grumbullues i grurit ka qenë 0.15 Euro me çka nuk janë pajtuar shumica e fermerëve të cilët kanë refuzuar me e dorzuar grurin në mullinj.
- Shumica e Mullinjëve kanë qenë të pajisur me sillos (hambar) për pranimin e drithit me çka sigurohen kushte të mira për ruajtjen e grurit.
- Çmimi i korrje- shirjes dhe respektimi i rendit nga ana e kombajnerëve është respektuar në përjashtim të rasteve të rralla.
- Numri i autokombajnave ka qenë i mjaftueshëm.
- Gjendja teknike e shumicës së kombajnave ka qenë e mirë.
- Kushtet atmosferike kanë qenë pjesërisht të përshtatshme në këtë fushatë . Peshat hektolitare e grurit ka qenë e mirë .
- Cilësia e grurit të këtij viti ka qenë e mirë.

Fushata e korrje-shirjes për vitin 2016 në Komunën e Lipjanit ka përfunduar më **27.07.2016**

